



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. 2020

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor shpall vend të lirë pune për:

- 1 (Një) Specialist farmacist në Sektorin e Monitorimit dhe Analizës së Rimbursimit, pranë Drejtorisë së Rimbursimit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.**

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces në prokurori apo gjykatë;
- Të mos jetë pushuar më parë nga administrata e FSDKSH-së apo Shërbimi Civil për thyrje të disiplinës a shkelje të tjera serioze;
- Të jetë pajisur me diplomën përkatëse të arsimit të lartë Shkenca Natyrore, Universiteti I Mjekësisë , Dega Farmaci;
- Eksperiencë pune;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja do të jetë avantazh. (dëshmi,çertifikata)
- Njohuri bazë në kompjuter;
- Aftësi komunikuese dhe pune në grup;
- Të jetë i gatshëm për shërbime të gjata jashtë qytetit;

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentat pranë Fondit, **brenda datës 11.03.2020**, si më poshtë;

- Kërkesë me shkrim për t'u punësuar;
- Jetëshkrimi i plotësuar (CV);
- Diplomë e noterizuar (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njëhësi nga Ministria e Arsimit);
- Diplomë Master e noterizuar;

- Listë notash e noterizuar;
- Dëshmi për kualifikime të ndryshme;
- Referencë pune nga vendi ose vendet e punës ku ka punuar;
- Fotokopje e Librezës së Punës që vërtetojnë eksperiencën në punë;
- Fotokopje kartës identitetit (ID);
- Dëshmi penaliteti (të datojë brenda 3 muajëve të fundit);
- Raport mjekësor për aftësi në punë (të datojë brenda 3 muajëve të fundit);

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentat të dorëzohen në zarf të mbyllur, i cili protokollohet.

Adresa:

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Rruga “Sami Frashëri” nr.8, Tel. +3554223815, E-mail: info@fsdksh.com.al.